



# **MONITORIMI I MEDIAVE Për Zgjedhjet Parlamentare 2005**

**Periudha e Monitorimit  
14 Maj – 9 Korrik 2005**

**Raporti Përfundimtar**

**Tiranë, 22 Qershor 2005**

# PËRMBAJTJA

<b>Përmbledhje Ekzekutive</b>	<b>3</b>
<b>Hyrje</b>	<b>4</b>
<b>Metodologjia dhe Terminologjia</b>	<b>5</b>
<b>Informacion i Përgjithshëm</b>	<b>6</b>
<b>Monitorimi i TELEVIZIONEVE</b>	<b>8</b>
<b>Spote Elektorale</b>	<b>29</b>
<b>Monitorimi i RADIOVE</b>	<b>32</b>
<b>Monitorimi i GAZETAVE</b>	<b>41</b>
<b>Gratë politikane në media gjatë fushatës elektorale</b>	<b>54</b>

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

- Në fazën e parë të monitorimit, kur ligji për median gjatë fushatës elektorale nuk kishte hyre në fuqi, një pjesë e mediave raportuan në mënyrë të njëanshme duke mbështetur dukshëm një parti. Kjo bën të mendojmë se edhe gjatë pjesës tjetër të vitit, vec fushatës elektorale, mund të ndodhë ky raportim i deformuar për publikun. Kjo bën të domosdoshme nga shoqëria civile dhe aktorë të tjerë të demokracisë, monitorimin e vazhdueshëm dhe permanent të sjelljes së medias, dhe mënyrën e drejtë të përcjelljes së lajmit tek publiku.
- Pas publikimit të raportit të parë, dhe me hyrjen në fuqi të ligjit elektoral, një pjesë e mediave të monitoruara ndryshuan në mënyrë të dukshme, nga një raportim i hapur në favor të një force politike, drejt balancimit. Këtu mund të përmendim TVA, KOHA, etj.
- Televizioni publik TVSH, nga një mbështetës i hapur i PS në fillim të fushatës, bëri përpjekje të dukshme drejt balancimit, bile në fazën e tretë të monitorimit, kaloi në anën e kundërt, në mbështetje të PD. Në fazën e fundit të fushatës, e reduktoi këtë mbështetje dhe u afrua drejt balancimit.
- Ka pasur media që patën një përmirësim të vazhdueshëm dhe rritje të nivelit të balancimit të informacionit. TV Alsat është një shembull i mirë në këtë drejtim.
- Vërejtëm me kënaqësi që pothuaj në të gjitha mediat, koha totale e raportimit për Qeverinë, u reduktua në mënyrë të vazhdueshme.
- Pothuajse në të gjitha mediat, koha totale për PD u rrit në javën e fundit të fushatës.
- Periudha e parë e monitorimit, që i përket dyjavëshit para fillimit të fushatës elektorale, si dhe periudha e monitorimit pasgjedhore, janë periudhat me pak të balancuara pothuaj në të gjitha mediat, krahasuar me periudhën e fushatës elektorale.
- Partitë e vogla patën një paraqitje shumë më të reduktuar se sa partitë e mëdha, pothuaj në të gjitha mediat.
- Gratë politike u raportuan në një mënyrë pothuajse të papërfillshme, krahasuar me burrat.
- Monitorimi i gazetave evidentoi në disa raste influencat politike në gazeta dhe anasjelltas.
- Disa parti të vogla me ndikim tek drejtuesit e gazetës ose pronarët e gazetave patën akses në disa gazeta në raport të përmbysur me rëndësinë e tyre në jetën politike shqiptare.
- Në ndryshim nga mediat e tjera, radiot patën një mbulim më të madh për Qeverinë.
- Radiot e monitoruara, në përgjithësi raportuan me një mungese kritikizmi, duke raportuar pozitivisht për të gjitha partitë politike.

***Ky projekt u mundësua falë mbështetjes së dhënë nga Konsorciumi për Demokraci dhe Qeverisje në Shqipëri, i cili financohet nga USAID nën marrëveshjen e bashkëpunimit nr. 182-A-00-04-00104-00 me National Democratic Institute for International Affairs. Opinonet e shprehura këtu nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID-it.***

***Gjithashtu ky projekt bëhet i mundur falë mbështetjes së Ambasadës Britanike në Tiranë. ACAC është i kënaqur të punojë së bashku me Ambasadën Britanike në këtë iniciativë dhe përshëndet mbështetjen e Ambasadës Britanike për nxitjen e një mjedisi të pavarur dhe të balancuar në Shqipëri.***

Ndërsa është e pamundur të vendoset demokracia në një vend pa pasur zgjedhje të vërteta, procesi demokratik shtrihet edhe më përtej Ditës së Zgjedhjeve. Qeverisja demokratike kërkon një qytetari aktive dhe të informuar. Shpesh, medias i referohemi si Pushteti i Katërt, gjë që tregon rolin e saj të rëndësishëm në një shoqëri. Në demokraci ne presim që media të veprojë si një mbikqyrës i ngjarjeve dhe vendimeve, për të ndihmuar qytetarët që të jenë të informuar për atë çka ndodh. Por ky rol mund të përmbushet vetëm atëherë kur pasqyrimi mediatik të ndjekë parime dhe praktika thelbësore.

Monitorimi i medias është një mjet që ndihmon gazetarët të raportojnë në një mënyrë më të saktë dhe më të barazpeshuar. Me pak fjalë ai duhet të konsiderohet si një mjet i cili do të rrisë besimin e qytetarëve në raportimet e përgjithshme të medias. Kudo që ekziston media, është e dobishme të ndiqet puna e saj dhe më pas të analizohet marrëdhënia e saj me subjektet e ndryshme. Monitorimi i medias është një disiplinë studimi që përmban elementë analitikë. Qëllimi i tij është që të ndihmojë median në krijimin e barazpeshës gjatë raportimit dhe për të pasqyruar gabimet profesionale. Gjatë periudhës së vëzhgimit detyra e skuadrës monitoruese është përfundimi i të dhënave që pasqyrojnë ndjenjat e vërteta të qytetarëve që shikojnë, dëgjojnë dhe lexojnë median e shënjestruar.

Sot ne përdorim më shumë metodologji dhe njëra është ndërmarrë nga Instituti European i Medias, EIM. Qëllimi i raporteve është të ndihmojnë median, po të jetë e nevojshme, për të korrigjuar raportimin e tyre për tematika të ndryshme që vrotton ekipi monitorues.

### **Parimet e gazetarisë së mirë**

Ekzistojnë parime thelbësore që pranojnë gjerësisht si përbërës të “gazetarisë së mirë”. Mes tyre janë:

- Respekto etikën e gazetarisë së mirë.
- Raporto në mënyrë të drejtpeshuar në lidhje me kohën/hapësirën dhe kontekstin e informacionit.
- Bëni dallimet ndërmjet zyrtarëve të qeverisë dhe partisë sunduese.
- Mos e përdorni Qeverinë si mjet promovues për kandidatët dhe alternativat e politikave.
- Shmangni caktimin e një kohe të tepruar për aktivitetet e qeverisë në kurriz të aktorëve të tjerë politikë.
- Gjithmonë ofroni anën tjetër/të sulmuar për t’iu përgjigjur kritikës.
- Media duhet të orientojë politikanët për atë që është e rëndësishme për qytetarët.
- Mos nxisni fjalime urrejtojeje.
- Media është rojtari publik dhe duhet të sillet si i tillë.

Thuhet se njëanshmëria dhe raportimi joprofesional nuk do të ndikojnë tek votuesit e vendosur. Për shkak se raportimi i dobët shtrembëron perceptimin, kjo gjë mund të ndikojë votuesit e pavendosur dhe ky shtrembërim i së vërtetës është gjithçka iu mbetet qytetarëve për të mbështetur vendimet e tyre. Në vend që t’i detyrojë shtetasit të marrin vendime, roli i medias është të informojë qytetarët për të gjitha ngjarjet e rëndësishme, me qëllim që ata të bëjnë një zgjedhje të mirë-informuar.

Ky raportim është i barazpeshuar, i përpiktë, i saktë dhe i drejtë. Ai ofron të njëjtën mundësi të gjitha palëve për të shprehur mendimet dhe idetë e tyre. Qeveritë kanë rolin e rëndësishëm që të mos e pengojnë median në luajtjen e këtyre funksioneve dhe të ndihmojnë pluralizmin e medias me qëllim që t’i shpalosin para publikut larminë më të gjerë të burimeve të informacionit.

Në monitorimin e medias përdoren dy metoda kryesore - cilësore dhe sasiore. Të dy parimet janë mjaft të rëndësishme për paraqitjen e një panorame të përgjithshme të raportimit të medias në një fushatë elektorale.

### **Analiza cilësore**

Në kërkimin cilësor elementët kryesorë janë konteksti dhe paraqitja.

**Konteksti** është vendosja në kohë dhe hapësirë e vetë informacionit. Për shembull, nëse partia politike A flet në kontekst pozitiv për veten e saj ose në kontekst negativ për ndonjë subjekt tjetër, një media nuk është e njëanshme thjesht sepse e transmeton informacionin. Ajo që ka rëndësi është nëse media, për një periudhë më të gjatë, jo vetëm për atë ditë, transmetoi informacion me kontekst pozitiv ose negativ mbi subjektet e ballafaquara në mënyrë përzgjedhëse në mënyrë që të zhvillohet një shabllon i spikatur.

**Paraqitja** është shkalla në të cilën ngjarjet raportohen me fakte (X gjë ndodhi) kundrejt sasisë së komentit redaksional ose të ndikimit mbi këto ngjarje.<sup>1</sup> Për shembull, fjalët mund të jenë pozitive ose negative. Gjithashtu, toni i përdorur prej gazetarit gjatë pasqyrimin të lajmit mund të ndikojë perceptimin. Së fundmi, mimika e fytyrës dhe gjuha e shenjave (për gazetarët televizivë) ndikon mënyrën se si perceptohet informacioni.

### **Analiza sasiore**

Analiza sasiore vlerëson kohën dhe hapësirën në të cilën një parti politike ose politikan u përmend, foli, u citua ose u shfaq në ekranin e televizorit.

**Kohë/Hapësirë e përgjithshme** do të thotë harku kohor që televizionet dhe radiot i kushtojnë raportimit mbi një subjekt të caktuar politik, ose, masa e hapësirës që gazetaret u kushtojnë aktiviteteve të partive politike ose Qeverisë.

**Citimi** është koha ose hapësira e dhënë për një gazetar për të ritreguar fjalët e dikujt tjetër.

**Sinkron (ose thënia e shkruar për median e shkruar):** është koha ose hapësira që media i jep partive politike për të shprehur opinionet e tyre politike dhe përfaqëson një pjesë të kohës së tyre të përgjithshme. Kjo kategori përfshin intervistat dhe njoftimet e bëra drejtpërdrejt nga partitë politike ose subjektet politike.

**Koha e objektit:** është koha kur subjekti X është duke folur për politikanin Y - politikani Y është objekt i fjalimit. Kjo përfshin rastet në të cilat gazetarët përmendin subjektet politike në artikujt e tyre ose kur të tjerët flasin për subjektet politike

**Burimi:** ku media merr informacionin, si p.sh. agjencitë e lajmeve ose mediat e tjera, si dhe deklarata të ndryshme shtypi, raporte dhe njoftime të tjera.

---

<sup>1</sup> Ju nuk do të gjeni në çdo grafik të cituar analizë për këtë lloj raportimi. Nëse nuk ka probleme madhore në këtë fushë, ne nuk do t'i paraqesim ato.

## INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Monitorimi i medias u krye nga katër organizata:

### **Koalicioni Shqiptar Kundër Korrupsionit (ACAC)**

ACAC u krijua në 2001 si një bashkim i mbi 150 organizatave joqeveritare dhe individëve, qëllimi i përbashkët i të cilëve ishte lufta e shoqërisë civile kundër korrupsionit, rritja e vetëdijes qytetare për shkaqet dhe kostot e korrupsionit, dhe shndërrimi i kësaj vetëdije në përkrahje të për të ulur dhe luftuar korrupsionin.

### **Instituti për Sondazhe dhe Opinione (ISO)**

I themeluar në vitin 200 ky institut është një qendër e pavarur për kërkime sondazhi i cili ofron shërbime për organizata të sektorit publik dhe privat. Në mënyrë të rregullt ISO shikueshmërinë e medias elektronike dhe lexueshmërinë e medias së shtypur. Përveç personelit të përhershëm, ISO punëson dhe 25 ekspertë të tjerë të jashtëm dhe ka një panel prej 4000 njerëzish në 36 rrethe të Shqipërisë.

### **Instituti për Kërkime Zhvillimi dhe Alternativa (IDRA)**

Kërkimet IDRA është njësi e kërkimeve për sondazh social dhe marketing e Institutit për Kërkime Zhvillimi dhe Alternativa (IDRA). Ai ofron studime për klientë institucionalë dhe privatë. Ai ka një rrjet prej më shumë se 150 intervistuesish të cilët mbulojnë të gjitha rajonet e Shqipërisë dhe Kosovës.

### **Qendra për Transparencë dhe Informacion të Lirë (CTFI)**

Qëllimi i kësaj qendre është rritja e ndërgjegjësimit publik për një demokratizim të vazhdueshëm të jetës shqiptare si dhe për zbatimin e politikave kombëtare në luftën kundër korrupsionit. Disa nga projektet e realizuara prej kësaj qendre janë: Maj-Dhjetor 2003: “Media për transparencë”.

### **Struktura e Monitorimit**

Projekti i përgjithshëm po kryhet nën ombrellën e ACAC. Projekti kryesohet nga Bordi Drejtues i përbërë prej 6 vete. Ky komision përcaktoi listën e përpiktë të mediave që do të monitorohen në këtë projekt. Mediat u zgjodhën sipas gjetjeve të një studimi të shkurtër mbi ndikimin e medias në Shqipëri.

Monitorimi i televizioneve – u krye nga ISO

Monitorimi i radiove – u krye nga IDRA

Monitorimi i gazetave – u krye nga CTFI

Në këtë projekt janë përfshirë 23 monitorues, përveç tre koordinatorëve, një koordinator kryesor dhe personal tjetër – teknikë, financiare, menaxherë të rrjetit. Personalitë u zgjodhën me kujdes për të mos qenë i njëanshëm dhe politikisht aktiv. Monitoruesit ndryshojnë rregullisht brenda tre grupeve të mediave që të mund të marrin sa më shumë informacion të ndryshëm që të jetë e mundur.

## **Lista e mediave të monitoruara**

**Televizionet:** TVSH, TOP CHANNEL, KLAN, KOHA, TVA, VIZION +, NEWS 24, ALSAT, TEUTA, EGNATIA.

**Radiot:** Radio Tirana, Top Albania Radio, Radio Rash, Radio +2

**Gazetat:** Gazeta Shqiptare; Panorama; Koha Jonë; Shekulli; Korrieri; Ballkan

### **Oraret e monitorimit**

**Televizionet:** 15.00-24.00 Në këtë periudhë kohore janë monitoruar vetëm edicionet e lajmeve dhe spotet elektorale të subjekteve politike.

**Radiot:** 07.00-10.00 dhe 15.00-18.00. Në këtë periudhë kohore janë monitoruar vetëm edicionet e lajmeve dhe spotet elektorale të subjekteve politike.

**Gazetat:** Janë monitoruar të gjitha çështjet politike.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është që të ilustronë skenën e medias shqiptare gjatë fushatës parazgjedhore. Ky është raporti i dytë, i cili do të pasohet nga dy të tjere, të cilët do të mbulojnë dy muaj monitorim të mediave, para, gjatë dhe pas fushatës zgjedhore të 3 Korrikut 2005.


NDI (National Democratic Institute for International Affairs), gjithashtu bëri të mundur konsulencën me dy ekspertë të Shoqatës së Gazetarëve të Rinj të Malit të Zi, të cilët ndihmuan gjatë trainimeve të monitorëve dhe përgatitjeve të raporteve.

# TELEVIZIONET




## ALSAT 14 Maj – 01 Korrik

Në bazë të analizës se mëposhtme kjo panoramë bën që televizioni Alsat për këtë periudhë të jetë kryesisht i balancuar por me një anim të lehtë për PD. Gjatë kësaj periudhë monitorimi TV Alsat i ka dhënë 30 % PD në një kontekst kryesisht pozitiv, 25% PS në kontekst pothuaj neutral, 14% Qeverisë në kontekst pozitiv dhe LSI 12% në kontekst me tepër pozitiv. Kjo është koha me e madhe e dedikuar LSI krahasuar me televizionet e tjera. Për sa i përket politikanëve diferenca midis kohës së Fatos Nano dhe Sali Berishës është e vogël por konteksti i Sali Berishës është me pozitiv se i Fatos Nano.




**TENDENCA** - Alsat është një shembull i qartë i përmirësimit të raportimit të balancuar, dhe i konvergencës në kohën totale të partive kryesore. Megjithëse në periudhën e parë të monitorimit kishte një prirje të mbështetjes ndaj PD, kjo prirje është në reduktim në fazat e mëvonshme. Koha totale e Qeverisë është në rënie drastike, ndërsa LSI ka pasur ngritje të ndjeshme të kohës totale në fazën e fundit



## 25 Qershor – 01 Korrik

Në këtë periudhe raportimi Alsat, ka raportuar kryesisht në mënyrë të balancuar. Megjithatë vihet re një mbështetje e lehtë për PD. Përsa i përket kohës totale, Alsat është i balancuar. Për partitë dhe qeverinë flitet kryesisht në dritë pozitive, megjithëse për PS raportohet në mënyrë të balancuar. PS dhe PD kanë të njëjtën sasi kohe 32% secila. Vihet re një kohë e konsiderueshme për LSI e cila ka 16% të kohës totale dhe kontekst pozitiv. Përsa i përket politikaneve Sali Berisha renditet i pari me një kontekst të balancuar kurse Fatos Nano që renditet pas tij ka një kontekst më tepër negativ.




## 03 Korrik - 09 Korrik


Gjatë periudhës pas zgjedhore Alsat ka ruajtur balancën totale në kohën e partive, duke i rritur kohët e të dy partive kryesore me 6%. Veçori e kësaj periudhe është se konteksti i raportimit të PS është bërë shumë më pozitiv se sa në periudhën e mëparshme.

## KLAN 14 Maj – 01 Korrik

Gjithmonë në bazë të monitorimeve në këtë periudhe ka rezultuar ky televizion ka bërë një pasqyrim pothuaj të balancuar, me një prirje të lehtë ndaj PD. Në këtë televizion, koha për PD dhe PS është në përgjithësi i balancuar pothuaj e barabartë, por konteksti i raportimit të partive është me një ndryshim tepër të vogël më shumë pozitiv për PD se sa për PS. Te dy liderët kanë marrë të njëjtën kohë në sinkron. Gjithashtu LSI ka kontekst pozitiv e cila ka marrë edhe 10% të kohës duke rezultuar më tepër kohë se Qeveria (7%).




**TENDENCA** - Në këtë televizion është raportuar pothuaj në mënyrë të balancuar (sidomos në periudhën e dytë të monitorimit), me një prirje të lehtë të mbështetjes së PD (sidomos në periudhën e tretë të monitorimit). Nuk vihen re luhajtje të mëdha të kursit, dhe Qeveria ka një paraqitje më të vogël krahasuar me televizionet e tjera në të gjithë periudhën. LSI ka një paraqitje të rëndësishme dhe në rritje në kohë totale dhe në kontekst.



## 25 Qershor – 01 Korrik

Në këtë periudhe monitorimi TV Klan, ka raportuar kryesisht për PD, PS, dhe LSI, duke i dhënë një mbështetje të lehte PD. Koha totale është ndare ndërmjet PD me 34% me kontekst pozitiv, dhe PS me 30% të kohës dhe kontekst të balancuar. LSI ka 13% të kohës dhe kontekst mjaft pozitiv, ndërsa partitë e tjera kanë 1-3% të kohës. Përsa i përket politikanëve, Berisha dhe Nano kanë pothuajse të njëjtën sasi kohe, dhe të dy raportohen në një dritë negative. Përkundrazi, Ilir Meta raportohet në një dritë kryesisht pozitive.




## 03 Korrik - 09 Korrik


Gjatë periudhës pas zgjedhore Klan ka thelluar raportimin në mbështetje të PD-se, duke e rritur kohën e saj totale në 36% me kontekst kryesisht pozitiv, dhe duke ulur kohën totale të PS-se në 18%, me kontekst kryesisht negativ. Gjithashtu vihet re mbështetja për Berishën, i cili ka kohën më të madhe në sinkron, dhe kontekst kryesisht pozitiv, kundrejt Nanos me kontekst kryesisht negativ. Gjithashtu LSI ka një reduktim të ndjeshëm të kohës totale.

## NEWS 24 14 Maj – 01 Korrik

News 24 ka një balancë shumë të mirë për sa i përket kohës së dy partive kryesore PD e PS secila me 26% dhe kontekste përgjithësisht pozitive. Qeveria ka 13% të kohës dhe kontekst pozitiv kurse LSI 8% dhe kontekst pozitiv. Sali Berisha ka më tepër kohë sinkron se sa Nano, dhe konteksti i të dyve është lehtësisht pozitiv




**TENDENCA** - Vërehet një raportim i balancuar, sidomos në fazën e tretë të monitorimit. Në fazën e fundit, ndihet një mbështetje e lehtë për PD. Megjithatë ka më tepër kohë totale për PS, konteksti i saj është kryesisht negativ, ndërsa për PD raportohet në një dritë me pozitive. Qeveria ashtu si në televizionet e tjera ka rënie në kohën totale nga faza në fazë, ndërsa LSI ka pasur rritje në kontekst dhe kohë totale.



## 25 Qershor – 01 Korrik

News 24 në këtë periudhe monitorimi një javë para zgjedhjeve, ka raportuar duke mbështetur lehtësisht PD. Megjithatë i ka dhënë më tepër kohe PS(32%), konteksti në të cilën është raportuar është kryesisht negativ. Kurse për PD është raportuar në 24% të kohës, por në kontekst pozitiv. LSI ka marrë 10% edhe kjo në kontekst pozitiv. Fatos Nano ka shumë më tepër kohë në sinkron, por në kontekst negativ. E kundërta ndodh me Berishën, i cili raportohet kryesisht në dritë pozitive.




## 03 Korrik - 09 Korrik


Gjatë periudhës pas zgjedhore News 24 ka ruajtur pothuajse të njëjtën balance, me veçorinë se në kohën e sinkroneve të politikanëve Ilir Meta ka dalë në vendin e parë me kontekst kryesisht pozitiv, ndërsa Sali Berisha ka kaluar në vendin e pestë me kontekst kryesisht negativ.

# TOP CHANNEL 14 Maj – 01 Korrik

PD ka marre 26% të kohës me kontekst përgjithësisht pozitiv, PS 25% dhe kontekst lehtësisht pozitiv, Qeveria 12% me kontekst pozitiv dhe LSI ka marre 8% ne kontekst kryesisht pozitiv. Në përgjithësi koha e sinkronit për politikanet kryesore si Nano dhe Berisha janë gati te njëjta si edhe konteksti është i balancuar. Po te marrim parasysh ndryshimin ne kontekstin e kohës totale të partive dhe të kontekstit të politikanëve, për këtë periudhe monitorimi dallojmë një raportim kryesisht te balancuar.




**TENDENCA** - Top Channel në periudhën e parë të monitorimit para fushatës elektorale, ka pasur një raportim shumë të balancuar në kohë dhe kontekst. Në periudhat e mëvonshme vihen re luhatje, të cilat kryesisht janë në mbështetje të lehtë të PS në kohë totale, dhe të PD në kontekst. Koha për Qeverinë vjen në rënie, ndërsa e LSI dhe partive të vogla në rritje



## 25 Qershor – 01 Korrik

Top Channel gjatë kësaj periudhe monitorimi, ka raportuar kryesisht në mënyrë të balancuar. Për PD është folur me një kontekst më pozitiv, ndërsa Qeverisë dhe PS i është dhënë më shumë kohë. Por ndërsa për Qeverinë flitet kryesisht pozitivisht, për PS flitet me shumë negativisht. PS ka marrë 32%, PD ka 30%, LSI gjithashtu ka një kontekst pozitiv në 11% të kohës. Sali Berisha është edhe politikanë që ka marrë më shumë kohë në këtë televizion duke lënë pas Fatos Nanon dhe konteksti i të dyve është lehtësisht negativ




## 03 Korrik - 09 Korrik

Gjatë periudhës pas zgjedhore Top Channel ka pasur një mbështetje të lehtë për PS, të cilës i ka dhënë një rritje prej 7% të kohës totale, duke e çuar në 39%, kundrejt PD me një kohë totale 32%




# TVSH 14 Maj – 01 Korrik

Në këtë periudhe monitorimi, TVSH ka një prirje të lehtë pro Qeveritare dhe pro PS. Ne TVSH, PD ka 27% te kohës me kontekst pozitiv, e pasuar nga PS me 26% me kontekst thellësisht pozitiv, dhe Qeveria me 15% edhe kjo në kontekst thellësisht pozitiv. TVSH i ka dhënë më tepër kohe Qeverisë se televizionet e tjera, dhe shumë më pak kohe LSI (3%). Në tabelën e sinkroneve mund të shohim se me tepër kohe ka Fatos Nano me kontekst kryesisht pozitiv, ndërsa Berisha ka më pak kohë dhe në një kontekst shumë më pak pozitiv se sa rivali i tij Nano.




**TENDENCA** - Periudha e parë e monitorimit, para fillimit të fushatës elektorale, ka qenë totalisht e prirur ndaj PS/Qeverisë, si në kohë totale dhe në kontekst. Me fillimin e fushatës elektorale, dhe hyrjen në fuqi të ligjit elektor, si dhe me kritikën që ju bë nga koalicioni ACAC, Presidenti i Republikës, etj, raportimi filloi të balancohej. Kjo kthesë shkoi deri atje sa në periudhën e tretë të monitorimit, balanca anonte nga opozita. Në fazën e fundit u vu re një zbutje e prirjes ndaj PD dhe Sali Berishes. LSI ka pasur një paraqitje relativisht të vogël, megjithëse në rritje, ndërsa Qeveria ka pasur një pasqyrim në rënie të vazhdueshme.



## 25 Qershor – 01 Korrik

Në këtë periudhe monitorimi, vihet re raportim i balancuar i TVSH përsa i përket partive politike si edhe kontekstit, por duke parë se PD-se i është dhënë më shumë kohë, dhe Sali Berisha ka më shumë kohë dhe kontekst pozitiv se sa Fatos Nano, mund të themi se TVSH ka anuar lehtësisht djathtas në këtë periudhe. TVSH i ka dhënë 31% të kohës në kontekst pozitiv për PD, dhe 27% të kohës për PS në kontekst pozitiv, kurse Qeveria në 6% të kohës ka një kontekst negativ. Përsa i përket partive të tjera të vogla TVSH i ka dhënë pothuaj një kohë të balancuar të gjithave. Politikani që ka folur më tepër në TVSH ka qenë Sali Berisha në kontekst pozitiv i pasuar nga Fatos Nano në kontekst negativ.




## 03 Korrik - 09 Korrik


Gjatë periudhës pas zgjedhore TVSH ka rritur kohën e PS me 10% dhe duke e çuar në kuotën e 37%, kundrejt 34% të PD. Ndërkohe vihet re ndryshim i kontekstit për PS nga kryesisht pozitive në negative. Gjithashtu për Berishën konteksti ka ndryshuar nga kryesisht pozitiv në periudhën e mëparshme në kryesisht negativ.

## EGNATIA 14 Maj – 01 Korrik

Përsa i përket këtij televizioni, ka një mbështetje për PS. ETV i ka dhënë 35% të kohës PS me një kontekst tepër pozitiv, 33% PD dhe 7% LSI me kontekste pozitive. Për Qeverinë ka 9% të kohës dhe konteksti është i balancuar. Sali Berisha ka më tepër kohe por konteksti i tij është shumë me negativ se sa i Nanos, megjithëse edhe për këtë të fundit është raportuar në kontekst negativ




**TENDENCA** - Pothuaj në të gjitha periudhat e monitorimit, Egnatia ka raportuar në mbështetje të PS në kohë totale dhe në kontekst. Kjo mbështetje është më e dukshme në fazën e dytë. Në fazën e katërt ka një mbështetje për PS kryesisht në kontekst. Ka një përpjekje për balancim në fazën e tretë



## 25 Qershor – 01 Korrik

Gjatë kësaj periudhe monitorimi, Egnatia TV ka raportuar kryesisht negativisht për PD, dhe kryesisht pozitivisht për PS. PD ka 39% në kontekst kryesisht negativ kurse PS ka 34% në kontekst kryesisht pozitiv. LSI ka 14% dhe kontekst pozitiv kurse partitë e tjera më të vogla nuk kanë zënë shumë vend në këtë televizion. Në tabelën e sinkroneve vihet re se Fatos Nano ka një avantazh të lehtë ndaj Berishës, ndërsa në kontekst, Berisha është raportuar në një dritë negative.




## 03 Korrik - 09 Korrik


Gjatë periudhës pas zgjedhore vihet re një ndryshim kursi për Egnatia, duke mbështetur dukshëm PD me një kohe totale prej 50% (ritje 11%), kundrejt 35% të kohës totale për PS. Gjithashtu Berisha nga vendi i dytë në kohën e sinkroneve, dhe me kontekst kryesisht negativ, ka kaluar i pari me kontekst kryesisht pozitiv.

## KOHA TV 14 Maj – 01 Korrik

Megjithëse koha totale midis dy partive të mëdha është thuajse e barabarte, PD (36%) dhe PS (35%), po ti shtojmë kohës se PS edhe atë të Qeverisë me një kontekst pozitiv, atëherë vërejmë një prirje të lehtë majtas të këtij televizioni gjate kësaj periudhe raportimi. Kontekstet janë pozitive pothuaj për të gjithë subjektet, përveç LSI e cila është raportuar në kontekst negativ, dhe me një kohe të papërfillshme (me pak se 1%). Fatos Nano ka patur më tepër sinkrone sesa Berisha por konteksti ka qenë i njëjtë.




**TENDENCA** - Në periudhën e parë të monitorimit, Koha TV ka pasur një raportim dukshëm në mbështetje të PS/Qeverisë. Në periudhat e mëvonshme është bërë perpjekje për balancim i cili është evident në fazën e tretë të monitorimit. Është karakteristike konteksti pozitiv në raportim pothuaj të gjithë subjekteve politike. Koha e raportimit të Qeverisë ka ardhur në rënie drastike. LSI ka qenë pothuajse e padukshme në këtë televizion, i cili në përgjithësi i ka dhënë shumë kohe partive të mëdha.



## 25 Qershor – 01 Korrik

Ky televizion i ka kushtuar shumicën e kohës dy partive të mëdha, duke mbështetur më shumë PD se sa PS në kohë dhe kontekst. PD ka marrë 47% të kohës në këtë televizion dhe konteksti i kësaj partie është vërtet shumë pozitiv. Përsa i përket PS ka marrë 37% dhe kontekst pozitiv gjithashtu. Partitë e tjera më të vogla si LSI, PDK, PR etj kanë marrë nga 2% në këtë televizion. Pothuajse të gjitha partitë kanë kontekste pozitive përveç LSI që ka kontekst negativ. Fatos Nano është politikan i që ka kohën më të madhe në sinkron dhe pas tij vjen Sali Berisha. Të dy kanë kontekste pozitive.




## 03 Korrik - 09 Korrik


Gjatë periudhës pas zgjedhore Koha TV ka pasur një ndryshim kursi, dhe ka raportuar në mbështetje të PS, duke ulur ndjeshëm kohën ndaj PD me 16%, me një kontekst kryesisht negativ, në kontrast me periudhën e parë që ishte kryesisht pozitiv. Gjithashtu Berisha ndryshe nga periudha paraelektoale, ka kontekst përgjithësisht negativ. Konkretisht PS ka 35% të kohës në kontekst pothuaj pozitiv, PD ka 31% të kohës në kontekst negativ, dhe LSI për herë të parë ka marrë 8% në kontekst pozitiv.

# TEUTA 14 Maj – 01 Korrik

Nga monitorimet e kryera rezulton që televizioni Teuta mbështet më tepër PD se PS. Teuta i ka kushtuar me te shumtën e kohës partive të madhe se televizionet e tjera. Kështu PD ka marre 42% të kohës me kontekst kryesisht pozitiv dhe PS ka marre 34% në kontekst pozitiv. Qeveria ka 10% të kohës dhe konteksti është pothuaj i balancuar. Duhet theksuar se PD ka marrë më tepër kohe në këtë Televizion se në Televizionet e tjera. Sali Berisha ka më tepër kohe sinkroni dhe konteksti i tij është pozitiv përballe atij të rivalit të tij Fatos Nano i cili ka kontekst më tepër negativ.




**TENDENCA** - Pothuaj në të gjitha periudhat e monitorimit, vihet re një tendencë e qartë për raportim në mbështetje të PD në kohë totale dhe në kontekst. Kjo tendencë është më e evidente në periudhën e tretë të monitorimit, dhe është zbutur pak në periudhën e fundit. Për Qeverinë pothuaj gjithmone ka pasur interes të vogël, ndërsa LSI dhe partitë e vogla kanë pasur një vend relativisht të vogël.



## 25 Qershor – 01 Korrik

Gjatë kësaj periudhe monitorimi vihet re qartë një tendence raportimi pozitiv drejt PD në këtë televizion. Kështu PD në kohën totale i takojnë (46% ) ne kontekst shume pozitiv, kurse PS ka 35% te kohës, në kontekst të balancuar. LSI ka marrë gjithashtu 8% të kohës në një kontekst të balancuar. Gazmir Bizhga ka marre më tepër kohe në sinkron se Sali Berisha ndërkohë që konteksti i të dyve është kryesisht pozitiv, ndërsa i Fatos Nanos konteksti është pothuajse negativ.




## 03 Korrik - 09 Korrik

Gjatë periudhës pas zgjedhore Teuta e ka thelluar raportimin dukshëm mbështetës për PD, duke i dhënë një rritje prej 19% kohës se saj totale, e cila shkon ne 65%, ndërsa PS ka një reduktim shumë të dukshëm të kohës totale prej 27%, duke e çuar PS ne kuotën 8% te kohës totale dhe me kontekst kryesisht negativ.




## TVA 14 Maj – 01 Korrik

Po te marrim parasysh kohen totale dhe kontekstin, del qe TVA gjatë kësaj periudhe monitorimi të këtë një anim të lehtë ndaj PS/Qeverise. PD ka 30% të kohës në këtë televizion me një kontekst përgjithësisht pozitiv, PS ka 26% dhe një kontekst pozitiv. Qeveria ka gjithashtu një kontekst pozitiv ne 12% të kohës dhe së fundi LSI me 5%.




**TENDENCA** - Në fazën e parë të monitorimit, para fillimit të fushatës elektorale, TVA ka pasur një raportim të dukshëm në mbështetje të PS/Qeverisë. Me fillimin e fushatës elektorale, në fazën e dytë të monitorimit, dhe më vonë, pati reformim të qëndrimit dhe një raportim pothuaj të balancuar. Vihet re një rënie e ndjeshme e kurbës së raportimit të Qeverisë, dhe një rritje e lehtë e raportimit për LSI dhe partive të vogla. Përsëri në periudhën paszgjedhore, vihet re një prirje e lehtë ndaj PS.



## 25 Qershor – 01 Korrik

Gjatë kësaj periudhe monitorimi një jave para zgjedhjeve, TVA ka raportuar në mënyrë pothuajse të balancuar, me një prirje të lehtë ndaj PS/Qeverise.PD gjatë kësaj periudhe ka 33% ne TVA, PS ka marre 28% të kohës totale dhe Qeveria ka marrë 8%. Po të shohim grafikun e konteksteve, rezulton se PS ka një kontekst në një dritë më shumë pozitiv se sa PD, ndërsa për Qeverinë është folur pothuajse gjithmonë pozitivisht. Në grafikun e kontekstit të politikanëve, konteksti i Berishës është më tepër negativ se sa i Nanos, ndërsa koha e sinkroneve që i është dhënë të dyve është pothuajse e njëjtë.




## 03 Korrik - 09 Korrik


Gjatë periudhës pas zgjedhore TVA ka thelluar mbështetjen për PS, e cila ka një rritje në kohën totale me 7% , ndërsa PD ka një ulje te kohës totale me 9% dhe me kontekst më shumë negativ.

# VIZION + 14 Maj – 01 Korrik

Në bazë të monitorimit të vazhdueshëm deri në ditën e votimit për këtë televizion mund të themi që Vizion + është kryesisht i balancuar me një anim të lehtë për PS. Në Vizion +, PS ka marre 27 % dhe me një kontekst më tepër pozitiv kurse PD 25% në kontekst pozitiv. Qeveria ka marre 14 % në kontekst tërësisht të balancuar, dhe LSI 6% me kontekst pozitiv. Sali Berisha ka qenë politikanë që ka patur më tepër sinkrone në këtë televizion por konteksti i tij është pak më tepër negativ sesa pozitiv. Ndërkohe Fatos Nano ka me pak kohe dhe një kontekst të balancuar




**TENDENCA** - Përveç fazës së parë, para fushatës elektorale, pjesa tjetër e raportimit nga Vizion +, ka qenë në mbështetje të lehtë të PS në kohë totale dhe kontekst. Vihet re një paraqitje e njëtrajtshme e PD në kohe totale, dhe një rritje e kohës së PS, sidomos në periudhën e fundit. Koha e paraqitjes së Qeverisë ka qenë në rënie drastike.



## 25 Qershor – 01 Korrik

Gjatë kësaj periudhe monitorimi Vizion + ka mbështetur më shumë PS se PD. PS në këtë televizion ka 32% të kohës në një dritë me pozitive, gjithashtu PD ka 25% të kohës. LSI ka marrë 7% dhe kontekst të balancuar. Fatos Nano ka marrë kohën më të madhe duke lënë pas Sali Berishën por edhe në këtë rast kontekstet e të dyve janë kryesisht negative




## 03 Korrik - 09 Korrik

Gjatë periudhës pas zgjedhore Vizion +, ka pasur një ndryshim kursi me një mbështetje të lehtë për PD, duke e rritur kohën e saj totale nga 25% në periudhën paraardhëse, në 38% të kohës totale, me kontekst kryesisht pozitiv


# **SPOTE ELEKTORALE**

Ne kete pjese do te prezantohen te dhenat mbi spotet elektorale te partive politike nga secili prej stacioneve televizive te transmetuara cdo dite nga ora 15.00-24.00 per periudhen 14 Maj deri ne 1 Korrik 2005. Duhet theksuar se kjo paraqitje nuk perfqason qendrimin e mediave ndaj partive politike, sepse partite politike vendosin sesa spote do te transmetojne ne televizione te caktuara.


**ALSAT 14 Maj – 1 Korrik 2005**




**NEWS24 14 Maj – 1 Korrik 2005**



**TOP CHANNEL 14 Maj – 1 Korrik 2005**




**EGNATIA 14 Maj – 1 Korrik 2005**




**KOHA**


14 Maj – 1 Korrik 2005

**TEUTA**


14 Maj – 1 Korrik 2005

**KLAN**


14 Maj – 1 Korrik 2005

**TVA**

14 Maj – 1 Korrik 2005

**TVA**

14 Maj – 1 Korrik 2005




**RADIOT**




# RADIO TIRANA 14 Maj – 01 Korrik

Ka pasur një mbulim të konsiderueshëm të Qeverisë me rreth 31% të kohës totale. Së bashku Qeveria dhe PS kanë rreth dy herë më shumë mbulim se PD e cila ka rreth 24% të mbulimit kohor të partive politike. Vihet re se kjo radio i ka dhënë një hapësirë më të pakët se radiot e tjera LSI me vetëm 4% të mbulimit kohor. Në përgjithësi kjo radio është fokusuar vetëm tek partitë e mëdha (PS dhe PD) dhe Qeveria të cilat zënë rreth 80% të mbulimit kohor. Konteksti i për Qeverinë është tejet pozitiv. Fatos Nano ka një kohe totale rreth 37% më të madhe se Sali Berisha dhe kjo gjë vërehet edhe në sinkrone ku Fatos Nano e ka përdorur mikrofonin rreth 32% më shumë se Sali Berisha. Edhe konteksti për Fatos Nanon është dukshëm më pozitiv.




**TENDENCA** - Nga analiza e trendeve të mbulimit kohor vihet re se kjo radio me afrimin e zgjedhjeve është munduar të mbyllë hendekun midis partive kryesore PD dhe PS dhe duke ulur kohën në dispozicion të qeverisë. Ky mund të thuhet se është një hap pozitiv por gjithsesi duhet thënë se përsëri niveli i mbulimit të qeverisë duhet të ishte më i pakët. Edhe nga pikëpamja e kontekstit përsëri duket se “pozitiviteti” i informacionit për qeverinë ka ardhur në ulje. Gjate ditëve të fundit të fushatës LSI pati një zhvillim pozitiv të dukshëm në aspektin kohor duke e shumëfishuar atë.



## 25 Qershor – 01 Korrik

Një javë përpara zgjedhjeve Radio Tirana ka vazhduar trendin e vërejtur në valën e tretë të monitorimit, për një përpjekje për mbulim më të balancuar të partive politike. PD ka pasur rreth 30% të hapësirës kohore ndërkohë që PS ka pasur rreth 26%. Por gjithsesi përsëri problemi i mbulimit të Qeverisë edhe në këtë periudhë shumë afër ditës së zgjedhjeve ka vazhduar duke i dhënë qeverisë rreth 18% të hapësirës kohore. Përsa i përket kontekstit ka pasur edhe këtu përpjekje për një balancim, por “përshorja” priset përsëri në lidhje me kontekstin e informacionit për Qeverinë që ka tendence pozitive. Trendi i balancimit mund të vërehet edhe në sinkronet e politikaneve kryesore ku Fatos Nano dhe Sali Berisha ka marrë pothuajse të njëjtën kohë në përdorimin e mikrofonit të Radio Tiranës.




## 03 Korrik - 09 Korrik


Kjo radio vazhdon të beje përjashtim përsa i përket mbulimit të partive politike pasi edhe pas zgjedhjeve i ka dhënë një kohë të konsiderueshme mbulimit të aktiviteteve të Qeverisë. Gjithsesi analiza paszgjedhore nuk mund të ketë të njëjten vlerë si ajo parazgjedhore dhe në këtë rast mbulimi të qeverisë është me i justifikueshem. PD ka marrë me shumë kohë se sa PS, ndërkohë që Fatos Nano vazhdon të jetë politikani me mbulimin më të madh në këtë radio por situatë e kontekstit është pothuajse e njëjtë ndërmjet tij dhe Sali Berishes duke dalë të dy në dritë pozitive.

# TOP ALBANIA RADIO 14 Maj – 01 Korrik

Gjatë kësaj kohe, kjo radio i ka kushtuar 20% të kohës Qeverisë, 32% PS-së dhe 26% PD-së. Në ndryshim nga faza e parë e monitorimit në këtë stacion kemi një ndryshim të kohës që i jepet PS-së, një rritje prej 14%. Kjo ka ardhur si pasojë e reduktimit të kohës vënë në dispozicion të Qeverisë që ka pësuar një rënie prej 16%. Në total koha PS/Qeveria nuk ka pësuar ndryshim në krahasim me valën e parë. Koha për PD-në është në po të njëjtin nivel. Konteksti i informacionit për PS-në dhe PD-në është krahasimisht i barazpeshuar, respektivisht me 62% dhe 63% të sinkroneve në dritë pozitive. Por duhet theksuar fakti që të dyja partitë, si dhe Qeveria dalin kryesisht në dritë pozitive. Ndër politikanët, Nano ka marrë 23% më shumë se Berisha, por nga pikëpamja e kontekstit të dy dalin në dritë pozitive. Gjatë kësaj kohe, PS-ja ka prezantuar në këtë radio 9 spote publicitare elektorale.



**TENDENCA** - Mbulimi kohor i partive kryesore ka ardhur duke u balancuar në këtë radio (rënie e PS dhe ngritje deri diku e PD) por problemi ka qenë edhe këtu mbulimi i Qeverisë. Gjithashtu kjo radio ka ardhur duke e rritur kohën e vënë në dispozicion të LSI nga periudha në periudhë. Përsa i përket kontekstit vihet re se ka një rënie të dukshme të "pozitivitetit" të informacionit për PS ne dy periudhat e fundit para ditës së zgjedhjeve.




## 25 Qershor – 01 Korrik

Gjate kësaj periudhe, vërehet se ka një përmbysje të raporteve të mbulimit kohor për partitë politike krahasuar me periudhën e mëparshme. PD tashme del në vend të parë me 33% të mbulimit kohor ndërkohe që ulet mbulimi kohor për Qeverinë. Gjithsesi mbulimi i Qeverisë në këtë periudhe kohore ka qenë i konsiderueshëm me rreth 30% të kohës. Ajo që vihet re në këtë periudhe është në fakt fokusimi i kësaj radioje vetëm në partitë kryesore dhe kjo është e shpjgueshme pasi në këtë periudhe edhe fushata elektorale intensive paraqitej kryesisht në formën e blloqeve të mëdha PS dhe PD (koalicion) ndërkohe që partitë jo të përfshira në këto koalicione LSI dhe LZHK kanë gjetur hapësirë në këtë periudhe. LSI ka një rritje në mbulimin kohor prej 6% krahasuar me periudhën e mëparshme duke arritur në 12% të kohës totale.

Duke parë edhe kontekstin e informacionit për partitë politike edhe këtu kemi një ndryshim ku konteksti i informacionit për PD është dukshëm në dritë pozitive ndërkohe që informacioni për PS dhe për Qeverinë është i balancuar.

Koha totale vënë në dispozicion të politikaneve kryesore kanë qenë përgjithësisht e balancuar por konteksti i informacionit për Fatos Nano është në dritë pozitive ndërsa konteksti për Sali Berishën është i balancuar.



## 03 Korrik - 09 Korrik


Edhe kjo radio ka qenë e balancuar gjatë kësaj kohe përsa i përket mbulimit kohor të partive politike me PD e cila ka zënë rreth 30% të kohës e ndjekur nga PS me 29% dhe LSI me 19%. LSI ka marrë në këtë radio me shumë kohe se sa në radiot e tjera. Ndërkohe konteksti është negativ për PS dhe më shumë pozitiv për PD duke pasur gjithashtu një numër shumë të madh sekuecash neutrale për të dyja partitë.

Në mbulimin e politikaneve vendin e parë në këtë radio e ka zënë Ilir Meta i ndjekur nga Fatos Nano dhe Sali Berisha me përafërsi të njëjtte kohe mbulimi. Por ndërkohe përsëri edhe këtu konteksti i informacionit për Fatos Nano është kryesisht negative ndërsa për Sali Berishën dhe Ilir Metën është me shumë pozitiv.


# RADIO RASH 14 Maj – 01 Korrik

Radio Rash ka rritur hapësirën e kohës së përgjithshme kushtuar PD-së me 8% duke e çuar atë në 30%. Koha e Qeverisë ka pësuar një reduktim nga 28% në 16%. PS-ja ka përsëri 26% të kohës totale, por duke e mbledhur me atë të Qeverisë del 42% e kohës totale. Konteksti për PS-në dhe PD-në është pothuajse njësoj; kryesisht pozitive, ndërsa për Qeverinë flitet në mënyrë shumë të dukshme përgjithësisht pozitivisht (në 70% të kohës). Kjo e fundit, ashtu sikundër edhe gjatë fazës së parë të monitorimit, bën që PS-ja dhe Qeveria të kenë një përparësi të dukshme. Kjo radio vazhdon të mos ketë sinkrone të politikanëve të ndryshëm të spektrit politik shqiptar, pra duke mos e “nxjerrë” mikrofonin jashtë studios.


## Koha Totale




## Konteksti




## Sinkronet e Politikanëve



## Konteksti i Politikanëve




**TENDENCA** - Përsa i përket mbulimit të partive kryesore kjo radio ka ruajtur njëtrajtshmërinë në periudha të ndryshme duke qenë përgjithësisht e balancuar. Ndërkohe vihet re një ulje e mbulimit të Qeverisë në tre periudhat e para me një rritje në periudhën e fundit. Ndihet edhe në këtë radio një rritje e konsiderueshme e mbulimit të LSI në periudhën e fundit para ditës së zgjedhjeve. Edhe konteksti ka qenë përgjithësisht i njëtrajtshëm gjatë gjithë periudhës.



## 25 Qershor – 01 Korrik

Përsëri edhe në këtë rast kemi te bëjmë me një përmbysje të raporteve të mbulimit krahasuar me periudhën e mëparshme. PD ka pasur një rritje prej 5% të mbulimit kohor duke arritur të ketë rreth 30% të kohës totale. PS ka pasur një ulje prej 3% duke pasur rreth 27% të kohës totale. E veçantë e kësaj radioje për këtë periudhë një-javore është mbulimi i konsiderueshëm i LSI-se e cila ka një rritje prej 13% në krahasim me kohën e mëparshme duke arritur në 23% të kohës totale.

Konteksti ka qene përgjithësisht i balancuar ku të dyja partitë kryesore dalin në një dritë pozitive.




## 03 Korrik - 09 Korrik


Pak a shume te njeten situatë paraqet edhe Radio Rash persa i perket mbulimit të partive politike. PD ka një paraqitje me shume pozitive kurse PS me shume negative. Sali Berisha ka një avantazh në mbulimin kohor të politikanëve kryesorë kundrejt Fatos Nanos dhe me një kontekst pozitiv. Vihet re se kjo radio i ka kushtuar pothuajse të njeten kohë Ilir Metes sa edhe Fatos Nanos.

## RADIO +2 14 Maj – 01 Korrik

Qeveria ka një rënie prej 6% në krahasim me valën e parë kur kjo hapësirë ishte 40%. Koha e PD-së është reduktuar në 17%, duke shënuar një rënie prej 8% në krahasim me fazën e parë të monitorimit. Për tu theksuar është fakti që kjo radio i ka kushtuar 19% të kohës totale të saj Lidhjes së Bleritë Shqiptare. Në valën e parë të monitorimit kjo forcë politike kishte më pak se 1% të kohës totale. Gjithsesi sasia e sekuencave pozitive dhe negative për Qeverinë në këtë radio është e balancuar. Ndërsa Lidhja e Bleritë Shqiptare nuk ka asnjë sekuence negative në këtë radio. Në kohë totale, Fatos Nano ka gati 3 herë më shumë kohë se Sali Berisha. Por duke parë kontekstin mund të themi se numri i sinkroneve me kontekst negativ është më i madh për Fatos Nanon, ndërkohë që Sali Berisha del në një dritë më pozitive.




**TENDENCA** - Në këtë radio ka një rënie të dukshme të mbulimit të qeverise në dy periudhat e fundit. Ndërkohe që mbulimi i PD dhe PS ka qenë pothuajse i njëtrajtshëm. Edhe kjo radio ka pasur një rritje të mbulimit të LSI në periudhën e fundit. Nga pikëpamja e kontekstit vihet re një sens në rritje i sekuencave negative për PS ndërkohe “pozitiviteti” i PD është i njëtrajtshëm. Vihet re një rritje shumë e dukshme e sekuencave pozitive për LSI në periudhën e fundit.



## 25 Qershor – 01 Korrik

Përsëri edhe në këtë rast kemi te bëjmë me një përmbysje te raporteve të mbulimit krahasuar me periudhën e mëparshme. PD ka pasur një rritje prej 5% të mbulimit kohor duke arritur të ketë rreth 30% te kohës totale. PS ka pasur një ulje prej 3% duke pasur rreth 27% te kohës totale. E veçantë e kësaj radioje për këtë periudhe një-javore është mbulimi i konsiderueshëm i LSI-se e cila ka një rritje prej 13% në krahasim me kohën e mëparshme duke arritur ne 23% të kohës totale.

Konteksti ka qene përgjithësisht i balancuar ku të dyja partitë kryesore dalin ne një dritë pozitive.



## 03 Korrik - 09 Korrik


Mbulimi i partive politike ka qene i balancuar. Edhe persa i perket kontekstit situatë është e balancuar me te dyja partitë kryesore. Persa i perket mbulimit te politikaneve Sali Berisha ka rreth dy here me shume kohe mbulimi sesa Fatos Nano dhe njekohesisht ka nje kontekst pozitiv kundrejt ketij te fundit.




# GAZETAT

## BALLKAN 14 Maj – 01 Korrik

Gazeta Ballkan i ka dhënë pothuajse të gjithë sipërfaqen partive më të mëdha politike relativisht 85%. Partisë Socialiste i ka dhënë një sipërfaqe prej 44 për qind krahasuar me PD që ka marrë 41 për qind. Konteksti midis dy partive është i balancuar. Berisha ka marrë më shumë sipërfaqe por kryesisht në kontekstin negativ, krahasuar me Nanon që zë më pak vend se Berisha por kryesisht në kontekstin pozitiv. Partia Socialdemokrate zë vendin e tretë me 5 për qind. Kryetari i kësaj partie, Skënder Gjinushi, zë vendin e tretë për nga sipërfaqja e dhënë politikanëve me kontekst tërësisht pozitiv. Qeveria në këtë gazetë ka zënë më pak se 1% , ndërsa partitë e tjera të vogla ruajnë këtë renditje: LSI me 4 për qind, PDR me 2 për qind dhe PBDNJ me 2 për qind.




**TENDENCA** - Kjo gazetë ka ruajtur raportet e kontekstit për dy partitë e mëdha politike, duke i balancuar gjithnjë e më shumë nga faza e parë e monitorimit ku konteksti pozitiv ishte më i përqendruar për PS, tek faza e katërt ku konteksti përgjithësisht është i balancuar. Ka një rritje të lehtë të sipërfaqes së dhënë PD e PS dhe një ulje të sipërfaqes dhënë LSI-së duke filluar nga faza e parë në të fundit.



## 25 Qershor – 01 Korrik

Është e balancuar ndaj dy partive kryesore politike për nga sipërfaqja dhe konteksti. Ndërsa është zvogëluar edhe më tej sipërfaqja për LSI që merr vetëm 2 për qind të sipërfaqes totale dhe kryesisht në kontekst negativ. Nano dhe Berisha kanë pothuajse të njëjtën sipërfaqe dhe në kontekst të balancuar.




## 03 Korrik - 09 Korrik

Është e balancuar si në sipërfaqe dhe kontekst për dy partitë kryesore politike, PS dhe PD. Berisha zë sipërfaqe sa dyfishi i Nanos ndërsa konteksti për të është kryesisht pozitiv.

# KORRIERI 14 Maj – 01 Korrik


I ka dhënë më shumë sipërfaqe PS me 35 për qind dhe kryesisht në kontekstin pozitiv, ndërsa PD ka marrë 31 për qind të sipërfaqes me kontekst të balancuar. Nano dhe Berisha zënë pothuajse të njëjtën sipërfaqe por kryetari i PS ka një kontekst më të fortë pozitiv krahasuar me Berishën. Ilir Meta zë vendin e tretë për nga sipërfaqja e dhënë dhe konteksti është pothuajse pozitiv. LSI ka marrë 20 për qind të sipërfaqes së dhënë partive politike dhe në një kontekst kryesisht pozitiv. Partitë e tjera të vogla zënë shumë pak vend.

## Koha Totale




## KORRIERI

## Konteksti




## Thëniet e Politikanëve




## KORRIERI

## Konteksti i Politikanëve




**TENDENCA** - Konteksti për të dy partitë politike ka ardhur duke u balancuar në periodën e katërt të monitorimit. Ajo ka pësuar ndryshime nga periudha e dytë ku PS kishte më shumë kontekst pozitiv krahasuar më atë të PD-së. Ndërkaq sipërfaqja e dhënë për partitë kryesore politike ka një grafik të thyer nga etapa në etape duke pësuar kështu një rënie për sipërfaqen e PS dhe duke u rritur sipërfaqja për PD. Gjithashtu LSI ka pësuar një rritje në ditët e afërta me votimet.



## 25 Qershor – 01 Korrik

Shtohet edhe më tej sipërfaqja e dhënë LSI prej 39 % e njëjtë me atë të PD-së ndërsa PS është ne vend të tretë me 19 për qind të sipërfaqes afërsisht sa kishte LSI në periudhat e tjera të monitorimit. Që të tre këto parti janë trajtuar kryesisht në kontekstin pozitiv. Ndër politikanët Meta zë vendin dytë menjëherë pas Berishës ndërsa Nano të tretin. Që të tre janë trajtuar të balancuar për nga konteksti.




## 03 Korrik - 09 Korrik


PD dhe Berisha kanë marrë më shumë sipërfaqe se sa PS dhe Nano. Konteksti për dy partitë është i balancuar, po ashtu edhe për dy politikanët, Nano dhe Berisha. Ka rënë sipërfaqja e dhënë për LSI dhe Metën.

## SHEKULLI 14 Maj – 01 Korrik

Ka qenë lehtësisht pranë Partisë Demokratike dhe opozitës për nga sipërfaqja e dhënë partive politike. PD është trajtuar në një kontekst pozitiv. Ndër politikanët kryesorë, Sali Berisha dhe Fatos Nano kanë marrë pothuajse të njëjtën sipërfaqe por në kontekst është trajtuar më shumë pozitivisht Kryetari I PD-së Sali Berisha. Në këtë gazetë qeveria ka zënë rreth 10 për qind të sipërfaqes totale me kontekst kryesisht negative. Partia e tretë është LSI me 14 % për nga sipërfaqja që ka marrë dhe ka një kontekst pozitiv. Pas kësaj vjen partia e katërt, Partia e Blerte me 8 për qind tërësisht në një kontekst pozitiv. Partitë e tjera të marra së bashku zënë një sipërfaqe prej 4 për qind, sipërfaqe relativisht e vogël e cila është ruajtur gjatë gjithë fazave të monitorimit.




**TENDENCA** - Ndryshimet e dukshme në këtë gazetë tregojnë për një mbështetje në rritje për PD që nga fillimi zyrtar i fushatës elektorale. Në përfundim të fushatës elektorale kjo gazetë i ka bërë një mbështetje të fortë PD-së dhe ka zvogëluar sipërfaqen për PS dhe u raportua në një kontekst edhe më negativ pikërisht në mes të fushatës elektorale. Kjo gazetë ka rritur mbështetjen për LSI në mënyrë të dukshme sidomos në javën e fundit të fushatës.



## 25 Qershor – 01 Korrik

Ka shtuar sipërfaqen e dhënë PD-së që ka arritur në 45 për qind, kryesisht në kontekstin pozitiv dhe rrjedhimisht është zvogëluar sipërfaqja e dhënë për PS deri në 24 për qind në një kontekst të balancuar. E njëjta sjellje është edhe ndaj LSI që ka marrë 20 për qind të sipërfaqes, ndërsa Ilir Meta zë vendin e parë duke shtyrë për në vendin e dytë dhe të tretë Nanon dhe Berishën. Meta dhe Berisha janë trajtuar kryesisht në kontekstin pozitiv ndërsa Nano në kontekst të balancuar. Javën e fundit ka rënë sipërfaqja e dhënë për Partinë e Bleritë ndërsa partitë e vogla zënë një vend të papërfillshëm




## 03 Korrik - 09 Korrik


Ka ruajtur balancimin e sipërfaqes ndërsa konteksti është lehtësisht pozitiv për Berishën dhe Nanon. LSI përsëri është në vendin e tretë në kontekstin neutral.

# KOHA JONË 14 Maj – 01 Korrik

Ka mbështetur Partinë Demokratike gjatë periudhës së monitorimit dhe ka qenë kritike ndaj PS dhe qeverisë. Sipërfaqja që zë PD është 35 për qind kryesisht në kontekstin pozitiv, ndërsa PS zë 31 për qind kryesisht në kontekstin negativ. Fatos Nano zë më shumë sipërfaqe se sa politikanët e tjerë por në kontekst negative, ndërsa Berisha është trajtuar kryesisht në kontekstin pozitiv. Qeveria zë 6 për qind të sipërfaqes në kontekst negativ. LSI zë një sipërfaqe prej 16 për qind e vendosur në kontekst pozitiv, ndërsa Ilir Meta renditet i treti ndër politikanët për nga sipërfaqja e dhënë dhe vendoset në kontekst kryesisht pozitiv. Partitë e tjera të vogla përfshirë dhe PDK zënë një sipërfaqe të vogël jo më shumë se 2 për qind.




**TENDENCA** - Gjatë katër periudhave të monitorimit të zgjedhjeve kjo gazetë ka ruajtur një rritje të vogël për PD si edhe një rënie të dukshme për PS. Kjo tendence ishte edhe më e fortë në ditët e fundit të fushatës elektorale. Koha jonë gjithashtu ka rritur vazhdimisht kohën e dedikuar për LSI. Përsa i përket kontekstit të këtyre partive, ai ka qenë pozitiv për PD dhe LSI dhe kryesisht negative për PS.





## 25 Qershor – 01 Korrik

Kjo gazetë ka rritur sipërfaqen për PD dhe LSI dhe ka zvogëluar atë për PS krahasuar me periudhat e tjera të monitorimit. Është ruajtur mbështetja për PD dhe kritikën për PS-në, ndërsa LSI dhe Meta janë trajtuar në kontekste neutrale ose pozitive. Nano dhe Berisha zënë dy vendet e para por Nano është plotësisht i trajtuar në kontekste negative.




## 03 Korrik - 09 Korrik


I është dhënë më shumë sipërfaqe PD dhe konteksti është tërësisht pozitiv. Ndërkaq Nano zë më shumë sipërfaqe krahasuar me Berishën por në kontekstin negativ. Ka një rënie sipërfaqja e dhënë për LSI dhe Metën.

# PANORAMA 14 Maj – 01 Korrik

Ka qenë kryesisht e balancuar ndaj dy partive të mëdha PS e PD duke ju dhënë pothuajse një sipërfaqe të barabartë dhe kontekst të balancuar. LSI është partia e tretë që ka marrë rreth 22 për qind të sipërfaqes, ndërsa vetë kryetari i LSI zë vendin e tretë ndër politikanët kryesorë. LSI dhe Meta janë trajtuar kryesisht në kontekstin pozitiv. Dy politikanët kryesorë Nano dhe Berisha kanë marrë gati të njëjtën sipërfaqe. Nano është trajtuar në kontekst të balancuar ndërsa Berisha në një kontekst lehtësisht negativ. Gazeta Panorama ka lënë vend më shumë se sa gazetatat e tjera për partitë e vogla. LZHK zë një sipërfaqe prej 8 për qind ndërsa PBDNJ, PDR, PSD nga 2 për qind secila. Qeveria ashtu si në shumicën e gazetave zë 2 për qind të sipërfaqes pra mjaft pak dhe kryesisht në kontekstin negativ.




**TENDENCA** - Ka një raport të balancuar mes partive kryesore në kontekst që është ruajtur në përgjithësi në etapat e para të monitorimit. Në etapën e tretë ka një rritje të kontekstit negativ për PD, ndërsa në etapën e katërt është e kundërta rritet konteksti pozitiv. Ka një rënie të lehtë të sipërfaqes për partitë e mëdha politike nga faza e parë në të katërtën ndërsa në këtë të fundit është rritur sipërfaqja për LSI.



## 25 Qershor – 01 Korrik

Është shtuar mbështetja për LSI e cila zë vendin e parë për nga sipërfaqja prej 32 për qind, ndërsa PD e PS zënë të njëjtin vend prej 23 për qind. Po ashtu Ilir Meta zë vendin e parë për nga politikanët duke lënë në vend të dytë e të tretë përkatësisht Berishën dhe Nanon. Edhe LSI është trajtuar kryesisht në kontekstin pozitiv. Javën e fundit ka një kontekst negativ të përndëruar për PS por jo edhe për Nanon, ndërsa konteksti është kryesisht pozitiv për PD por jo edhe për Berishën. Ndër partitë e vogla ka sipërfaqe të shtuar për LZHK dhe PSD.




## 03 Korrik - 09 Korrik


Ka një kontekst të balancuar kryesisht neutral për të dy partitë e mëdha por lehtësisht negative për PS-në, ndërsa sipërfaqja e dhënë është pak më e madhe për PD se për PS-në. Berisha ka marrë më shumë sipërfaqe kryesisht në kontekstin pozitiv ndërsa Nano trajtohet lehtësisht në kontekstin negativ.

# GAZETA SHQIPTARE 14 Maj – 01 Korrik

Ka qenë kryesisht afër Partisë Socialiste për nga sipërfaqja e dhënë prej 38 për qind krahasuar me atë të PD-së me 32 për qind, ndërsa konteksti ishte kryesisht pozitiv për PS dhe kryesisht negative për PD. Berishës i është dhënë më shumë sipërfaqe se sa Nanos por në kontekst kryesisht negative, ndërsa kryetari i PS-s është trajtuar kryesisht në kontekstin pozitiv. LSI zë vendin e tretë me 13 për qind me kontekst përgjithësisht të balancuar dhe kryetari i saj, Ilir Meta, renditet i treti ndër politikanët për nga sipërfaqja që i është dhënë me kontekst po gjithashtu të balancuar. Qeveria zë vetëm 4 për qind të sipërfaqes kryesisht në kontekstin pozitiv ndërsa partitë e tjera të vogla zënë një vend të papërfillshëm.




**TENDENCA** - Nga faza e dytë dhe të tretë të monitorimit ka rritje të kontekstit pozitiv për PS dhe atij negativ për PD. Ndërsa në fazën e katërt konteksti është lehtësisht pozitiv në favor të PS-së. Sipërfaqja e dhënë për PD ka ardhur në rënie deri në fazën e katërt të monitorimit ndërsa ajo për PS është në ngritje. Edhe LSI ka rritje të sipërfaqes së dhënë periodën e katërt.



## 25 Qershor – 01 Korrik

I ka dhënë më shumë sipërfaqe PD kryesisht në kontekst të balancuar dhe më pak PS por në një kontekstin të balancuar. Është shtuar fort sipërfaqja e dhënë LSI, krahasuar me periudhat e tjera të monitorimit, rreth 23 për qind por kryesisht në kontekstin negativ. Berisha vazhdon të ruajë vendin e parë për nga sipërfaqja e marrë por tani në kontekst të balancuar ndërsa Nano renditet i dyti por në kontekst pozitiv.



## 03 Korrik - 09 Korrik

Sipërfaqja për PD e PS është e balancuar ndërsa konteksti është lehtësisht pozitiv për PD dhe lehtësisht negative për PS. Berisha zë më shumë sipërfaqe se Nano. Konteksti për Berishën dhe Nanon është i balancuar

## GRATË POLITIKANE NË MEDIA GJATË FUSHATËS ELEKTORALE

Nga grafikët e treguar në këtë pjesë shohim mbulimin mediatic në kategori të ndara që kanë patur pesë politikanë në krahasim me pesë gra politikanë në radiot, televizionet dhe gazetatat e monitoruara. Zgjedhëm këtë metodë për shkak se nëse do të prezantonim të gjithë burrat dhe gratë e përfshirë në politikë në këto grafikë, rezultati do të ndikohej nga numri i madh i burrave në politikë dhe në listën e kandidatëve duke mos treguar ndikimin e raportimit mediatic për opinionet e grave. Përsa i përket mbulimit mediatic të grave në politikë të krahasuara me mbulimin mediatic të politikanëve, ne kemi hartuar një metodë të veçantë.

Po të shohim renditjen e kohës që televizionet i kanë kushtuar grave politikanë, do të shohim se ka një mosbalancim të madh të kohës midis burrave dhe grave. Koha totale që media i ka kushtuar 5 politikanëve gra më të përmendura në media, dhe 5 politikanëve burra është paraqitur në grafikun e mësipërm, ku gratë kanë 3% dhe burrat 97%. Po të shohim dhjetë politikanët e parë në kohë total dhe sinkrone apo citime, do të shohim se pothuaj nuk ka asnjë grua. Ky raport shkon deri në 95% me 5% në favor të burrave, në rastin e radiove dhe në 4% me 96% për gazetatat e monitoruara. Nuk e dimë se është faji i mediave që nuk i kanë kushtuar kohë të mjaftueshme grave në politikë, apo e politikës që nuk i ka dhënë vendin e duhur grave.

